



"LOJTARËT" KRYESORË DHE KONKURRENCA NË PROKURIMET PUBLIKE NË SEKTORIN E SHËNDETËSISË

HULUMTIM

për rreziqet nga korrupsioni në prokurimet
publike në sektorin shëndetësor
gjatë periudhës nga viti 2015 deri në vitin 2024

“Lojtarët” kryesorë dhe konkurrenca në prokurimet publike në sektorin e shëndetësisë

Hulumtim për rreziqet nga korrupsioni në prokurimet publike në sektorin shëndetësor gjatë periudhës nga viti 2015 deri në vitin 2024

(превод на публикацијата Клучни „играчи“ и конкуренција во јавните набавки во здравството
Истражување за корупциските ризици во јавните набавки во здравствениот сектор во периодот од 2015 до 2024 година

Botuesi: Qendra për Komunikime Qytetare

Autorët: German Filkov, Sabina Fakic dhe Marko Mitevski

Përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe: Agon Ismaili

Dizajn grafik: Brigada Dizajn

Edicioni elektronik

“LOJTARËT” KRYESORË DHE KONKURRENCA NË PROKURIMET PUBLIKE NË SEKTORIN E SHËNDETËSISË

HULUMTIM

për rreziqet nga korrupsioni
në prokurimet publike
në sektorin shëndetësor gjatë
periudhës nga viti 2015 deri në vitin 2024

Shkup, dhjetor 2025

PËRMBAJTJA

1. GJETJET KRYESORE	5
2. KONTEKSTI DHE QASJA METODOLOGJIKE	7
3. HULUMTIMI I DETAJUAR.....	8

1. GJETJET KRYESORE

- Në dekadën e fundit, vlera e kontratave të nënshkuara për prokurime publike në fushën e shëndetësisë është zmadhuar më tepër se dyfish, nga 135 milionë euro në vitin 2015 në 293 milionë euro në vitin 2024¹. Në të njëjtën kohë, numri i kompanive që kanë fituar kontrata është rritur vetëm me 12 %, nga 765 në 853 kompani. Ky trend sugjeron që rritja e shpenzimeve në kujdesin shëndetësor nuk ka çuar drejt një konkurrence më të gjerë, por se fondet vazhdojnë të përqendrohen te një numër i kufizuar furnizuesish.
- Në periudhën 2015-2024, me rritjen e vlerës së tenderëve, vërehet një ndryshim i vogël në strukturën e kompanive farmaceutike që kanë pjesëmarrjen më të madhe të tregut të prokurimeve publike në sektorin shëndetësor. Në vitin 2015, dhjetë kompanitë më të mëdha kanë fituar kontrata me vlerë 83 milionë euro dhe kanë marrë pjesë me 62 % në vlerën totale të kontratave, ndërsa në vitin 2024, ato kanë fituar 145 milionë euro dhe kanë pasur një pjesëmarrje prej 49 %. Kjo sugjeron në një rënie të moderuar të përqendrimit. Njëkohësisht, në treg dominojnë disa furnizues të mëdhenj, të cilët gjatë viteve e kanë forcuar pozicionin e tyre.
- Dy kompani - Allkalloid Kons dhe D-r Panovski kanë konsoliduar dominimin e tyre në prokurimet publike në sektorin e shëndetësisë gjatë dekadës së fundit dhe tani kontrollojnë një të katërtën e vlerës totale të tenderëve në këtë sektor. Pjesëmarrja e tyre rritet në një të tretën kur analizohen vetëm prokurimet e ilaçeve, materialeve të harxhueshme mjekësore, pajisjeve mjekësore dhe të ngjashme, pra kur analizohet thelbi i prokurimeve në sektorin shëndetësor.
- Në dekadën e fundit, vetëm 10 kompani kanë fituar kontrata për prokurime publike me vlerë mbi 1 miliard euro në sektorin e shëndetësisë, apo më tepër se gjysmën prej atyre prokurimeve (53 %).
- Me kalimin e viteve është shënuar rritje në vlerën e tenderëve që u ndahen furnizuesve më të mëdhenj të kujdesit shëndetësor në procedura në të cilat ata kanë qenë ofertuesit e vetëm dhe nuk kanë pasur konkurrencë. Mesatarisht, nëse 5 vjet më parë kompanitë më të mëdha farmaceutike nuk kanë pasur konkurrencë në një të tretën e vlerës së kontratave (33 %), tani ato nuk e kanë atë konkurrencë në më tepër se gjysmën e kontratave të nënshkuara (55 %).
- Parë në nivel programesh, prokurimi i ilaçeve dhe materialeve të harxhueshme për trajtimin e diabetit pasohet nga një dyfishim i shpenzimeve dhe rritje në dominimin nga një kompani.
- Tregu i vaksinave është shumë i përqendruar, edhe atë madje 75 % të vlerës së vaksinave furnizohen vetëm nga një kompani. Deri 97 % të vlerës së kontratave për imunizimin e popullsisë në periudhën janar 2024 - dhjetor 2026 janë nënshkruar në procedura në të cilat është paraqitur vetëm një ofertë.

1 Për vëllimin e prokurimeve publike në sektorin shëndetësor, lexoni më tepër në hulumtimin "Sistemi i shëndetësisë shpenzon gjithnjë e më tepër, ndërkaq jep gjithnjë e më pak"

- Kontratat për prokurimin e ilaçeve për sëmundjet e rralla në vitin 2024 janë nënshkruar me 11 kompani, por 4 prej tyre kanë qenë bartës 86 % të vlerës totale të tenderëve. Gjysma e vlerës përfshihet në kontrata që janë nënshkruar në procedura tenderimi në të cilat ka munguar konkurrencë.
- Në prokurimet për reagensë, teste dhe materiale për testime laboratorike - tre kompani kontrollojnë 86 % të tregut midis institucioneve publike shëndetësore.
- Aplikimi i flamurit të kuq të Byrosë për Prokurime Publike, i emërtuar “koluzion dhe marrëveshje e fshehtë”, ku treguesi është përqendrimi i lartë i kontratave që i janë ndarë një ose një numri të vogël të ofertuesve, i vë në zonën e kuqe madje 9 prej 10 institucioneve publike të kujdesit shëndetësor me vëllimin më të madh të tenderëve.

2. KONTEKSTI DHE QASJA METODOLOGJIKE

Financimi i qëndrueshëm i kujdesit shëndetësor që plotëson nevojat e qytetarëve paraqet një sfidë thelbësore për të gjitha vendet, pavarësisht nga shkalla e zhvillimit ekonomik të tyre. Sistemet e kujdesit shëndetësor përballen me presion të vazhdueshëm për të ofruar shërbime cilësore në kushte të resurseve të kufizuara, kostove në rritje dhe pritshmërive të zmadhuara të popullsisë. Prandaj, është me rëndësi thelbësore të merret në konsideratë jo vetëm se sa fonde ndahen, por edhe me sa efikasitet dhe transparencë shpenzohen ato fonde. Një nga burimet e brendshme më të rëndësishme për përmirësimin e efikasitetit të shpenzimeve është sistemi i prokurimeve publike - mekanizmi përmes të cilit sigurohen ilaçet, pajisjet dhe shërbimet mjekësore me rëndësi qenësore për funksionimin e sistemit të kujdesit shëndetësor. Zbatimi më efikas i prokurimeve publike dhe maksimizimi i vlerës për paratë e shpenzuara është një parakusht i rëndësishëm për ofrim të shërbimeve më të mira të kujdesit shëndetësor pa ngarkesë financiare shtesë mbi buxhetin.

Të gjitha informacionet në dispozicion - si shkencore ashtu edhe empirike - çojnë në konkluzionin se niveli i ulët i konkurrencës është një nga faktorët kryesorë që ndikon drejtpërsëdrejti në mënyrë negative mbi efikasitetin dhe integritetin e prokurimeve publike. Mungesa e konkurrencës mund të rezultojë me çmime më të larta, vlerë më të ulët për paratë dhe zvogëlimin e besimit të publikut ndaj sistemit.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të verifikohet niveli i konkurrencës në prokurimet publike në sektorin e kujdesit shëndetësor gjatë një periudhe prej një dekade (2015-2024). Në këtë hulumtim analizohet niveli i përqendritimit të kontratave për prokurime publike midis një numri të caktuar kompanish, si dhe ndryshimet që mund të përcaktohen në raport me konkurrencën gjatë periudhës së analizuar. Më konkretisht, konkurrenca është paraqitur jo vetëm në nivelin e tërë sektorit të kujdesit shëndetësor, por edhe në nivelin e autoriteteve individuale kontraktuese dhe operatorëve ekonomikë me qëllim të detektimit të një trendi të rritjes ose uljes së dominimit të disa kompanive të caktuara.

Fokus i posaçëm në këtë hulumtim është vendosur mbi tenderët në të cilët nuk ka pasur konkurrencë, pra në rastet kur kontratat janë nënshkruar në bazë të vetëm një oferte. Në kushtet kur numri i kontratave të tilla është në rritje, kjo konsiderohet si një nga treguesit më të mëdhenj për rritje të rrezikut për korrupsion dhe transparencë të zvogëluar në prokurimet publike në sektorin shëndetësor.

Përlllogaritjet për vlerën e prokurimeve publike në nivel të kompanive janë bërë bazuar në vlerën e kontratave të nënshkruara.

Ky hulumtim zbatohet në kuadër të projektit “Parandalimi i Korrupsionit në Prokurimet Publike në sektorin e shëndetësisë”, që e zhvillon Qendra për Komunikime Qytetare me mbështetje financiare nga NED.

3. HULUMTIMI I DETAJUAR

Në dekadën e fundit, vlera e kontratave të nënshkruara për prokurime publike në fushën e shëndetësisë është zmadhuar më shumë se dyfish, nga 135 milionë euro në vitin 2015 në 293 milionë euro në vitin 2024². Në të njëjtën kohë, numri i kompanive që kanë fituar kontrata është rritur vetëm me 12%, nga 765 në 853 kompani. Ky trend tregon që rritja e shpenzimeve në kujdesin shëndetësor nuk ka çuar drejt një konkurrence më të gjerë, por se fondet vazhdojnë të përqendrohen te një numër i kufizuar furnizuesish.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të gjitha 110 institucionet shëndetësore zbatojnë prokurime për nevojat e tyre. Gjatë kësaj, vetëm Ministria e Shëndetësisë dhe Institucioni Publik në Fushën e Shëndetësisë për Nevojat e Institucioneve Publike të Kujdesit Shëndetësor – Shkup zbatojnë prokurime të centralizuara për më shumë institucione.

Vlera e përgjithshme e prokurimeve publike në sektorin e shëndetësisë ka shënuar një rritje më të madhe nga vlera e prokurimeve publike në përgjithësi. Konkretisht, në periudhën 2015-2024 vlera e përgjithshme e prokurimeve publike ka shënuar rritje prej 76 %, ndërsa në sektorin e kujdesit shëndetësor ka shënuar rritje prej 118 %. Gjatë kësaj, pjesa e prokurimeve publike në kujdesin shëndetësor në vëllimin e përgjithshëm të prokurimeve në vend është në shkallë të lartë edhe atë prej 22 %.

Në vlerën totale të kontratave për prokurime publike, përveç ilaçeve, materialeve mjekësore dhe pajisjeve, përfshihen edhe të gjitha blerjet e nevojshme për funksionimin normal të institucioneve shëndetësore publike, si për shembull – lëndët djegëse, materialet për zyrë, mirëmbajtja e higjienës, etj.

Çështja e konkurrencës në prokurimet publike në kujdesin shëndetësor është me rëndësi thelbësore, sepse, në kushtet kur konkurrenca mungon, resurset financiare dhe pushteti janë të përqendruara te një numër i vogël kompanish. Konkurrenca e zvogëluar dhe përqendrimi i lartë çojnë në çmime më të larta për ilaçet dhe materialet, shumëllojshmëri dhe disponueshmëri të reduktuar të produkteve, inovacion të ngadalësuar dhe rrezik të zmadhuar për korrupsion.



2 Për vëllimin e prokurimeve publike në sektorin shëndetësor, lexoni më tepër në hulumtimin “Sistemi i shëndetësisë shpenzon gjithnjë e më tepër, ndërsaq jep gjithnjë e më pak”

Parametri i parë që është analizuar në këtë hulumtim është numri i kompanive me të cilat janë nënshkruar kontratat për prokurimet publike. Gjatë periudhës prej 10 vitesh, ky numër ndryshon nga 765 në vitin 2015 e deri në 853 në vitin 2024. Nga kjo rezulton që rritja e madhe e vlerës së kontratave të nënshkruara për prokurimet publike në sektorin e shëndetësisë nuk pasohet në mënyrë proporcionale nga një rritje e numrit të kompanive. Kështu, nëse rritja e vlerës së kontratave të nënshkruara është 118 %, rritja e numrit të kompanive që kanë fituar kontrata është vetëm 12 %. Pra, kjo tregon se fondet e zmadhuara buxhetore nuk kanë çuar në futje të furnizuesve të rinj më të mëdhenj, por se kompanitë ekzistuese e kanë konsoliduar pozicionin e tyre.

Rezulton se në vitin 2024, çdo e katërta kompani që ka lidhur një kontratë për prokurime publike në këtë shtet, ka një kontratë për prokurime publike në fushën e kujdesit shëndetësor. Më konkretisht, në vitin 2024, si bartës të kontratave për prokurime publike figurojnë 3,551 kompani, ndërsa 853 prej tyre janë në sektorin e kujdesit shëndetësor.

Vlera e prokurimeve publike kundrejt numrit të kompanive që janë bartës të kontratave

Viti	Vlera e kontratave të nënshkruara në denarë	Vlera e kontratave të nënshkruara në euro	Numri i kompanive që janë bartës të kontratave
2015	8,297,320,752	134,915,785	765
2016	8,706,689,848	141,572,193	748
2017	7,951,489,927	129,292,519	739
2018	10,438,161,082	169,726,196	772
2019	10,652,420,224	173,210,085	895
2020	10,153,744,022	165,101,529	824
2021	16,764,439,295	272,592,509	782
2022	11,627,558,565	189,065,993	787
2023	19,087,345,180	310,363,336	869
2024	18,048,613,864	293,473,396	853

Është me rëndësi të theksohet se përlllogaritjet për vlerën e prokurimeve publike në nivel të kompanive bëhen në bazë të vlerës së kontratave të nënshkruara, për dy arsye kryesore. Së pari, njoftimet për kontratat e realizuara paraqiten në Sistemin Elektronik për Prokurime Publike vetëm në gjashtë vitet e fundit, pra pas miratimit të Ligjit të ri për Prokurimet Publike në vitin 2019. Së dyti, të dhënat për kontratat e realizuara nuk përmbajnë gjithmonë informacione të plota dhe të sakta, kurse kjo e kufizon mundësinë e analizës sistematike të tyre.

Në periudhën 2015-2024, me rritjen e vlerës së tenderëve, vërehet një ndryshim i vogël në strukturën e kompanive farmaceutike që kanë pjesën më të madhe të tregut të prokurimeve publike në kujdesin shëndetësor. Në vitin 2015, dhjetë kompanitë më të mëdha kanë fituar kontrata me vlerë 83 milionë euro dhe kanë marrë pjesë me 62 % në vlerën totale të kontratave, ndërsa në vitin 2024, ato kanë fituar 145 milionë euro dhe kanë pasur një pjesëmarrje prej 49 %. Kjo sugjeron në një rënie të moderuar të përqendrimit. Njëkohësisht, në treg dominojnë disa furnizues të mëdhenj, të cilët gjatë viteve e kanë forcuar pozicionin e tyre.

Në vitin 2015, secila nga dhjetë kompanitë me pjesëmarrjen më të madhe në prokurimet publike në sektorin shëndetësor kanë lidhur kontrata me një vlerë totale prej 83.4 milionë euro, ose afërsisht dy të tretat (62 %), ndërsa pjesa tjetër prej 38 % është shpërndarë midis 755 kompanive tjera. Në vendin më të lartë ka qenë Allkaloid Kons me 14.7 milionë euro, e pasuar nga D-r Panovski me 11.7 milionë euro. Më tepër se 10 milionë ka edhe kompania Biotek. Në dhjetëshin e parë të kompanive janë edhe Feniks Farma, Zegin, Promedika, Avicena, Farma Trejd, Elbijor dhe Makedonijalek.

Top 10 kompanitë me pjesëmarrjen më të madhe në prokurimet publike në sektorin shëndetësor në vitin 2015

Emri i kompanisë	Vlera e kontratave në denarë	Vlera e kontratave në euro	Pjesëmarrja në prokurimet në sektorin shëndetësor
ALLKALOID KONS SHPKPV Shkup	903,832,011	14,696,455	11 %
SHA D-R PANOVSKI Shkup	718,873,748	11,689,004	9 %
BIOTEK SHPK Shkup	670,032,082	10,894,831	8 %
FENIKS FARMA SHPKPV Shkup	581,022,244	9,447,516	7 %
TD ZEGIN SHPK Shkup	545,913,355	8,876,640	7 %
PROMEDIKA SHPK Shkup	468,417,270	7,616,541	6 %
AVICENA SHPK Shkup	404,995,027	6,585,285	5 %
FARMA TREJD SHPKPV Shkup	295,313,429	4,801,844	4 %
ELBIJOR SHPKPV Shkup	272,370,529	4,428,789	3 %
MAKEDONIJALEK SHPK Shkup	268,976,972	4,373,609	3 %
Totali	5,129,746,667	83,410,515	62 %

Allkaloid Kons është përsëri në pozitën më të lartë në vitin 2024, me një vlerë prej 40.6 milionë euro, që paraqet rritje prej 177 % të vlerës së tenderëve gjatë dhjetë viteve të fundit. Pas saj është përsëri D-r Panovski me një rritje edhe më të lartë të vlerës së kontratave të nënshkruara, edhe atë për 212 %, në shumën prej 36.5 milionë euro. Pa ndryshim, në vendin e tretë është edhe kompania Biotek, me një rritje prej 37 % dhe me vlerë të kontratave prej thujase 15 milionë euro. Në vitin 2024, në pozitën e 4-të nuk është Feniks Farma, por kjo është rezultat i dinamikës me të cilën lidhen kontratat për prokurimet publike. Kontratat më të mëdha për sa i përket vlerës, kjo kompani i nënshkruan për prokurimin e

insulinës dhe materialeve tjera mjekësore për trajtimin e pacientëve me diabet. Kontrata e nënshkruar në vitin 2023 është kontratë dyvjeçare dhe e mbulon edhe vitin 2024.

Top 10 kompanitë me pjesëmarrjen më të madhe në prokurimet publike në sektorin shëndetësor në vitin 2024

Emri i kompanisë	Vlera e kontratave në denarë	Vlera e kontratave në euro	Pjesëmarrja në prokurimet e sektorin shëndetësor
ALLKALLOID KONS SHPKPV Shkup	2,499,440,229	40,641,305	14 %
SHA D-R PANOVSKI Shkup	2,244,921,875	36,502,795	12 %
BIOTEK SHPK Shkup	917,185,956	14,913,593	5 %
AVICENA SHPK Shkup	691,887,697	11,250,206	4 %
FARMA TREJD SHPKPV Shkup	619,145,187	10,067,401	3 %
PROMEDIKA SHPK Shkup	417,162,448	6,783,129	2 %
MAKEDONIJA LEK SHPK Shkup	397,010,981	6,455,463	2 %
CARSO PHARM SHPKPV Ilinden	384,370,951	6,249,934	2 %
GALINOS FARM SHPK Ilinden	375,645,474	6,108,056	2 %
SINERXHI MEDIKALL SHPK Shkup	372,770,804	6,061,314	2 %
Totali	8,919,541,602	145,033,197	49 %

Edhe pse pjesëmarrja e dhjetë kompanive të para në vlerën totale të prokurimeve publike në kujdesin shëndetësor ka shënuar rënie të vogël – nga 62 % në vitin 2015 në 49 % në vitin 2024 – përqendrimi vazhdon të jetë i lartë. Ky zvogëlim nuk vjen si pasojë nga rritja e konkurrencës, por nga një rritje e konsiderueshme e vlerës totale të prokurimeve, e cila e tejkalon rritjen e pjesëmarrjeve të firmave veças. Në esencë, struktura tregtare mbetet pothuajse e pandryshuar, gjë që konfirmon se rritja e fondeve buxhetore nuk ka çuar në një zgjerim të konsiderueshëm të rrethit të furnizuesve.

Kjo situatë tregon se pavarësisht rritjes së vlerës totale të prokurimeve publike dhe zgjerimit të vogël të tregut, përqendrimi mbetet i konsiderueshëm dhe konkurrenca është e kufizuar, gjë që e përcakton kontekstin për një analizë më të thellë të kompanive kryesore në gjetjen e mëposhtme.


Për të pasur një pasqyrë më të qartë për situatat, pjesëmarrja e dhjetë kompanive është analizuar edhe vetëm për sa u përket prokurimeve të ilaçeve, materialeve të harxhueshme mjekësore, pajisjeve mjekësore dhe mirëmbajtjes së tyre, ndërkaq jo edhe për kostot tjera që imponohen për funksionimin e institucioneve publike shëndetësore, siç janë punimet e ndërtimit, lëndët djegëse, materialet për zyrë, mirëmbajtja e higjienës, ushqimi, uniformat, siguracioni, etj. Në një raport të këtillë, pjesëmarrja e 10 kompanive të para ka qenë 76 % në vitin 2015, kurse 63 % në vitin 2024.

Dy kompani - Allkalloid Kons dhe D-r Panovski, kanë konsoliduar dominimin e tyre në prokurimet publike në sektorin e shëndetësisë gjatë dekadës së fundit dhe tani kontrollojnë një të katërtën e vlerës totale të tenderëve në këtë sektor. Pjesëmarrja e tyre rritet në një të tretën kur analizohen vetëm prokurimet e ilaçeve, materialeve të harxhueshme mjekësore, pajisjeve mjekësore dhe të ngjashme, pra kur analizohet thelbi i prokurimeve në sektorin shëndetësor.

Në periudhën 2015-2024, vihet re se dy kompani, Allkalloid Kons dhe D-r Panovski, e kanë zmadhuar pjesëmarrjen e tyre në prokurimet publike shumë më shpejt se kompanitë e tjera.

Në vitin 2015, të dy kompanitë kanë pasur të nënshkruara kontrata me vlerë totale prej 26.4 milionë euro, ndërsa në vitin 2024 vlera e kontratave të tyre është zmadhuar thuajse për tre herë dhe ajo ishte 77.1 milionë euro. Me kontratat e nënshkruara në këtë mënyrë në vitin 2015, të dy kompanitë kishin një pjesëmarrje prej 20 % në totalin e prokurimeve publike në sektorin shëndetësor, ndërsa në vitin 2024 pjesëmarrja e tyre arriti madje në 26 %. Veçmas, të dy kompanitë kanë një rritje të pjesëmarrjes së tyre në prokurimet publike me nga 3 pikë përqindjeje. Kjo rritje është posaçërisht e rëndësishme nëse e dimë që shoqërohet me një rritje të madhe të vlerës së prokurimeve publike.

**Vlera e kontratave për prokurime publike
(në euro)**



Pjesëmarrja prej 26 % e kompanisë Allkalloid Kons dhe e kompanisë D-r Panovski është në vlerën totale të kontratave të prokurimeve publike në të cilën, përveç ilaçeve, materialeve mjekësore dhe pajisjeve, janë përfshirë edhe të gjitha blerjet e nevojshme për funksionimin normal të institucioneve publike të kujdesit shëndetësor.

Nëse nga prokurimet totale të institucioneve shëndetësore publike do të përjashtoheshin punimet e ndërtimit, lëndët djegëse, materialet për zyrë, mirëmbajtja e higjienës, ushqimi, uniformat, sigurimet etj., ndërsa do të mbeteshin ilaçet, të gjitha llojet e materialeve të harxhueshme mjekësore, pajisjet mjekësore dhe mirëmbajtja e tyre, atëherë pjesëmarrja e këtyre dy kompanive do të ishte 33 %.

Në dekadën e fundit, vetëm 10 kompani kanë fituar kontrata për prokurime publike me vlerë prej mbi 1 miliard euro në sektorin e kujdesit shëndetësor, apo më tepër se gjysmën prej atyre prokurimeve (53 %).

Në dhjetë vitet e fundit, vetëm dhjetë kompani kanë fituar kontrata për prokurime publike në sektorin e kujdesit shëndetësor me vlerë totale prej mbi 1 miliard euro, që paraqet më tepër se gjysma (53 %) e vlerës totale e të gjithë tenderëve në këtë periudhë. Këto të dhëna qartë tregojnë se tregu i prokurimeve publike në sektorin shëndetësor është shumë i përqendruar dhe që pjesa më e madhe e mjeteve buxhetore paguhet te një numër i kufizuar furnizuesish.

10 kompanitë me vlerat më të mëdha të prokurimeve publike në sektorin shëndetësor (2015-2024)

Kompania	Shuma totale në denarë	Shuma totale në euro	Pjesëmarrja
SHA D-R PANOVSKI Shkup	14,506,305,417	235,874,885	11.9 %
ALLKALLOID KONS SHPKPV Shkup	14,341,955,218	233,202,524	11.8 %
PROMEDIKA SHPK Shkup	5,816,978,806	94,585,021	4.8 %
FENIKS FARMA SHPKPV Shkup	5,489,872,959	89,266,227	4.5 %
AVICENA SHPK Shkup	5,678,616,405	92,335,226	4.7 %
BIOTEK SHPK Shkup	5,826,595,697	94,741,393	4.8 %
FARMA TREJD SHPKPV Shkup	4,348,079,241	70,700,475	3.6 %
MAKEDONIJALEK SHPK Shkup	3,342,765,399	54,353,909	2.7 %
ZEGIN SHPK Shkup	2,929,979,541	47,641,944	2.4 %
SINERXHI MEDIKALL SHPK Shkup	2,233,469,250	36,316,573	1.8 %
Totali		1,049,018,178	53.0 %

Gjatë periudhës së analizuar 2015-2024, struktura e dhjetë kompanive kryesore mbetet e jashtëzakonisht e qëndrueshme, me ndryshime të vogla në përbërjen dhe rangimin e tyre. Këto të dhëna konfirmojnë se prokurimet publike në sektorin shëndetësor në dhjetë vitet e fundit janë zhvilluar në kushte të stabilitetit të madh të tregut, por me konkurrencë të ulët, me ç'rast disa kompani e diktojnë dinamikën dhe vlerën e kontratave. Struktura e tillë bart rreziqe që ndërliiden me varësinë nga një numër i vogël furnizuesish, konkurrencë potencialisht më të dobët në treg dhe efikasitet të reduktuar të konsumit publik.

Me kalimin e viteve është shënuar rritje në vlerën e tenderëve, të cilët furnizuesit më të mëdhenj të kujdesit shëndetësor i fitojnë në procedura në të cilat ata kanë qenë ofertuesit e vetëm dhe nuk kanë pasur konkurrencë. Mesatarisht, nëse 5 vjet më parë kompanitë më të mëdha farmaceutike nuk kanë pasur konkurrencë në një të tretën e vlerës së kontratave (33 %), tani ato nuk e kanë atë konkurrencë në më tepër se gjysmën e kontratave të lidhura (55 %).

Trendi i rritjes së prokurimeve me një ofertues të vetëm është një nga treguesit më të fortë për rrezik të zmadhuar për korrupsion në sektorin shëndetësor. Në vend që tenderët të sigurojnë çmimin dhe cilësinë më të mirë përmes konkurrencës midis numrit më të madh të ofertuesve, ato po shndërrohen në mekanizëm për transferimin e mjeteve publike te një qark i kufizuar aktorësh ekonomikë.

Vlera e kontratave të nënshkruara në të cilat kompanitë e mëdha kanë qenë ofertuesit e vetëm është në rritje të vazhdueshme. Më konkretisht, nëse në vitin 2020 kontratat në të cilat kompania D-r Panovski ka qenë ofertuesi i vetëm, kanë pasur pjesëmarrje prej 39.7 % në totalin e kontratave të ndara, në vitin 2025 kjo pjesëmarrje është 62.5 %. Në rastin me kompaninë Allkalloid Kons, kjo rritje është edhe më e theksuar dhe pjesëmarrja e kontratave në të cilat nuk ka pasur konkurrencë në një dekadë është rritur nga 16.2 % në 63.2 %.

Pjesëmarrja e vlerës së kontratave për prokurime publike të nënshkruara pa konkurrencë

Emri i kompanisë	2020	2021	2022	2023	2024
SHA D-R PANOVSKI Shkup	39.7 %	43.0 %	47.6 %	53.1 %	62.5 %
ALLKALLOID KONS SHPKPV Shkup	16.2 %	37.4 %	19.1 %	55.9 %	63.2 %
PROMEDIKA SHPK Shkup	29.3 %	24.3 %	39.0 %	43.6 %	48.0 %
FENIKS FARMA SHPKPV Shkup	29.7 %	79.6 %	22.9 %	90.0 %	42.4 %
AVICENA SHPK Shkup	78.4 %	79.3 %	73.9 %	87.5 %	80.5 %
BIOTEK SHPK Shkup	41.1 %	44.9 %	56.3 %	62.3 %	55.3 %
FARMA TREJD SHPKPV Shkup	24.7 %	60.9 %	34.3 %	68.9 %	52.9 %
MAKEDONIJA LEK SHPK Shkup	13.4 %	11.2 %	10.3 %	17.7 %	21.7 %
ZEGIN SHPK Shkup	13.5 %	21.2 %	24.3 %	43.2 %	39.2 %
SINERXHI MEDIKALL SHPK Shkup	47.1 %	74.1 %	62.4 %	65.5 %	84.2 %

Pjesëmarrja më e madhe e kontratave në të cilat janë nënshkruar ofertues të vetëm është e Sinerxhi Medikall dhe Avicena. Më saktësisht, në rastin me Sinerxhi Medikall, ky trend ndryshon nga 47.1 % në vitin 2020 në 84.2 % në vitin 2024, kurse në rastin me Avicena, niveli ka qenë jashtëzakonisht i lartë edhe në vitin 2020 edhe atë 78.4 %, ndërsa në vitin 2024 është rritur në 80.5 %.

Në përgjithësi, rritja e madhe e vlerës së prokurimeve publike në sektorin shëndetësor pasohet nga një numër gjithnjë më i ulët i ofertuesve në tenderët. Pothuajse gjysma e vlerës së kontratave nënshkruhen përmes procedurave të tenderit në të cilat ka marrë pjesë vetëm nga një ofertues. Mungesa e konkurrencës ka potencialin të përqendrojë pasurinë dhe ndikimin midis një grupi të vogël

lojtarësh dominues dhe të çojë në rritje të çmimeve, ulje të cilësisë së shërbimeve shëndetësore për pacientët dhe ulje të shumëllojshmërisë së ilaçeve.

Të dhënat tregojnë se në periudhë prej vetëm pesë vitesh, në numrin mesatar të ofertave në tenderët në sektorin shëndetësor është shënuar rënie nga 3.30 oferta për tender (viti 2020) në 2.64 oferta (viti 2024). Kjo rënie nënkupton se gjithnjë e më pak kompani po konkurrojnë në tenderët, gjë që e zvogëlon efektivitetin e prokurimeve publike si mekanizëm për shpenzime efikase. Gjatë kësaj, rënia në sektorin e shëndetësisë është më e madhe sesa në sistemin e përgjithshëm të prokurimeve publike në shtet, që sugjeron se sektori i shëndetësisë është veçanërisht i lëndueshëm. Konkurrenca e zvogëluar nënkupton më pak opsione për përzgjedhje të furnizuesve, kushte më të dobëta për çmimin dhe cilësinë, si dhe rrezik i zmadhuar nga krijimi i një “tregu të mbyllur”, i cili dominohet nga një ose disa kompani.

Një nga treguesit kryesorë për vlerësimin e rreziqeve për korrupsion është pikërisht konkurrenca dhe pjesëmarrja që kanë tenderët e nënshkruar me vetëm një ofertues në prokurimet e përgjithshme.

Të dhënat për numrin mesatar të ofertave janë përlogaritur për periudhën 2020-2024, pra për periudhën pas miratimit të Ligjit të ri të Prokurimet Publike. Për sa i përket periudhës së mëparshme, këto të dhëna nga ESPP-ja nuk mund të shkarkohen të plota sepse janë pjesë integrale e të ashtuquajturave evidenca të procedurave me kërkesë për mbledhjen e ofertave.


Konkurrenca në sektorin shëndetësor është gjithmonë më e ulët se konkurrenca në prokurimet publike të përgjithshme në nivel shtetëror. Pra, nëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut numri mesatar i ofertave në periudhën 2020-2024 ndryshon nga 3.58 në 2.82, në sektorin e shëndetësisë ky numër ndryshon nga 3.30 në 2.64.




Parë në nivel programesh, prokurimi i ilaçeve dhe materialeve të harxhueshme për trajtimin e diabetit pasohet nga një dyfishim i shpenzimeve dhe rritje në dominimin nga një kompani.

Vlera e prokurimeve publike të insulinës dhe materialeve të harxhueshme për trajtimin e diabetit për periudhën 2015-2016 ka qenë 22 milionë euro, ndërsa për 2023-2024, ajo arrin një shumë prej 39 milionë euro. Nëse bëjmë një krahasim të kompanive që janë bartës të këtyre kontratave gjatë një periudhe prej 10 vitesh, rezulton se 5 nga 7 kompanitë me të cilat janë nënshkruar kontratat janë të njëjtat kompani. Për më tepër, nëse në vitin 2016 pjesëmarrja e Feniks Farma ka qenë 34 % në vlerën totale të këtyre kontratave prej 7.5 milionë euro, në tenderët e zbatuar për nevojat e pacientëve në periudhën 2023-2024 pjesëmarrja e asaj kompanie është rritur në afërsisht 19.5 milionë euro, apo 52 %.

Kompanitë që janë bartëse të kontratave për prokurime të insulinës dhe materialit të harxhueshëm për diabet 2015-2016



Kompanitë që janë bartëse të kontratave për prokurime të insulinës, glukagon, gjilpëra për insulinë dhe shirita për matjen e sheqerit, pompa të insulinës me material të harxhueshëm 2023-2024




Gjatë periudhës 2023-2024, nga gjithsej 12 kontratat e nënshkruara për prokurimin për insulinë, glukagon, gjiipëra për insulinë dhe shirita për matjen e sheqerit, pompa të insulinës me materiale të harxhueshme dhe sensorë për matje të vazhdueshme të glicemisë për periudhën janar 2023 deri në dhjetor të vitit 2024, 7 kontrata janë nënshkruar me vetëm një ofertë të paraqitur në pjesët më të veçuara të tenderit. Për më tepër, vlera e këtyre kontratave me vetëm një ofertë është 1,998,052,593 denarë, që paraqet 83.29 % të vlerës së të gjitha 12 kontratave, e cila është 2,398,973,793 denarë. Të dhënat për numrin e ofertuesve në tenderin e zbatuar në vitin 2014 nuk janë relevante sepse në atë kohë nuk janë publikuar të dhënat për numrin e ofertave në nivel të një pjese të tenderit, por për tërë tenderin.

Tregu i vaksinave është shumë i përqendruar, edhe atë madje 75 % të vlerës së vaksinave furnizohen vetëm nga një kompani. Deri 97 % të vlerës së kontratave për imunizimin e popullsisë në periudhën janar 2024 - dhjetor 2026 janë nënshkruar në procedura në të cilat është paraqitur vetëm një ofertë.

Nëse vlera e kontratave të nënshkruara për prokurimin e vaksinave për një periudhë dyvjeçare në vitet 2015 dhe 2016 ka qenë 3.9 milionë euro, atëherë për prokurimin e vaksinave për një periudhë trevjeçare, pra janar 2024 deri në dhjetor 2026, janë nënshkruar kontrata me vlerë prej 17.5 milionë euro. Në mënyrë drastike janë ndërruar bartësit kryesorë të kontratave. Kështu, nëse në vitin 2015 Elbijor ishte bartës i 74 % të vlerës së kontratave, 10 vjet më vonë fjalën e fundit e ka Allkalloid Kons me një pjesëmarrje prej 74 %, që donë të thotë 12.3 milionë euro.

Kompanitë që janë bartës të kontratave për prokurimin e vaksinave për imunizim të vazhdueshëm dhe imunizim sipas indikacioneve epidemiologjike të popullatës




Nëse në vitin 2015 Makedonijalek ishte në vendin e dytë, tani atë pozicion e mban D-r Panovski.

Kontratat për prokurimin e barnave për sëmundjet e rralla në vitin 2024 janë nënshkruar me 11 kompani, por 4 prej tyre kanë qenë bartës të 86 % të vlerës totale të tenderëve. Gjysma e vlerës përfshihet në kontrata që janë nënshkruar në procedura tenderimi në të cilat ka munguar konkurrencë.


Shpenzimet për ilaçet për sëmundjet e rralla në dekadën e fundit janë rritur nga 90 milionë denarë në 1 miliard denarë (apo nga 1.5 në 19 milionë euro). Gjatë periudhës 10-vjeçare, me rritjen e vlerës së prokurimeve për ilaçet për sëmundje të rralla, numri i furnizuesve gjithashtu është zmadhuar dhe ndryshuar. Në vitin 2015, Zegin ka dominuar në listën e 7 furnizuesve, për dallim nga viti 2024 kur 4 kompani kishin pjesëmarrje më të madhe.

Kompanitë që janë bartës të kontratave për prokurime për ilaçet për sëmundje të rralla në vitin 2015



Lista e kompanive me të cilat janë nënshkruar kontratat për prokurimin e ilaçeve për sëmundje të rralla në vitin 2024 përfshin 11 operatorë ekonomikë. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e vlerës së kontratave u përket vetëm 4 prej tyre. Ky është një trend që mund të vërehet edhe në vitet e fundit.

Kompanitë bartëse të kontratave për prokurimin e ilaçeve për sëmundje të rralla në vitin 2024



Ndërkaq, sa i përket elementit të konkurrencës, në procedurat në të cilat është paraqitur vetëm një ofertë janë nënshkruar kontrata me vlerë prej 590,483,150 denarë (9.6 milionë euro).


Në prokurimet për reagensë, teste dhe materialeve për testime laboratorike - tre kompani kontrollojnë 86 % të tregut midis institucioneve publike shëndetësore.

Avicena dhe Biotek dominojnë në tenderët për prokurim të reagensëve dhe testeve. Këta janë tenderë që kryesisht janë vetëm formalitet sepse zbatohen për ndonjë aparat të përzgjedhur tashmë, që donë të thotë se është e qartë kush do ta fitojë tenderin edhe para se të fillojë procedura. Aparatet paraprakisht janë fituar si donacion, janë dhënë për përdorim prej kompanive që shesin reagensë, ose janë blerë. Prokurimi i reagensëve dhe testeve në nivel vjetor arrin edhe deri në vlerën prej 29 milionë euro. Gjatë 10 viteve, shpenzimet për reagensët dhe testet janë zmadhuar për 81 %³.

Në periudhën e fundit prej 5 vitesh për të cilën ka të dhëna të sakta lidhur me konkurrencën, pjesëmarrja e tenderëve me një ofertë është midis 70 % dhe 80 %.

Siç mund të shihet nga grafiku i mëposhtëm, në vitin 2015 Biotek ka dominuar me kontrata të nënshkruara në vlerë prej 8.6 milionë euro dhe me pjesëmarrje prej 54 %. Pas saj është Avicena me një pjesëmarrje prej 24 %. Një dekadë më vonë, pra në vitin 2024, Biotek është ende e para, me një rritje të vlerës së kontratave deri në shumën prej 9.5 milionë euro, por me pjesëmarrje të zvogëluar në 33 %. Menjëherë pas saj është Avicena me pjesëmarrje prej 32 % dhe vlerë të kontratave të nënshkruara në shumë prej rreth 9.1 milionë euro.

Kompanitë bartëse të kontratave për prokurim të reagensëve dhe testeve



³ Më tepër detaje mund të lexoni në hulumtimin mbi rreziqet për korrupsion në prokurimet publike në sektorin e shëndetësisë në periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2024 “Sistemi i shëndetësisë shpenzon gjithnjë e më tepër, ndërkaq jep gjithnjë e më pak”.

Aplikimi i flamurit të kuq të Byrosë për Prokurime Publike, i quajtur “koluzion dhe marrëveshje e fshehtë”, ku treguesi është përqendrimi i lartë i kontratave që i janë ndarë një ose një numri të vogël të ofertuesve, i vë në zonën e kuqe madje 9 nga 10 institucionet publike të kujdesit shëndetësor me vëllimin më të madh të tenderëve.

Ministria e Shëndetësisë në vitin 2024 ka nënshkruar kontrata me vlerë prej 42.8 milionë euro dhe 64 % prej tyre u janë ndarë vetëm gjashtë kompanive. Kjo pjesëmarrje është edhe më e madhe nëse e paraqesim situatën në vitin 2023, kur është zbatuar prokurimi dyvjeçar për insulinë dhe materiale të harxhueshme për trajtim të diabetit. Atëherë, pjesëmarrja e gjashtë kompanive: Allkalloid Kons, Feniks Farma, D-r Panovski, Farma Trejd, Carso Pharm dhe Makedonijalek ka qenë 80 %.

Prezantim i përqendrimit të kontratave të ndara të Ministrisë së Shëndetësisë në vitin 2024

Emri i kompanisë	Vlera e kontratave të nënshkruara në denarë	Vlera e kontratave të nënshkruara në euro	Përqindja e tenderëve të fituar
ALLKALLOID KONS SHPKPV Shkup	568,476,773	9,243,525	21.6
SHA D-R PANOVSKI Shkup	286,318,206	4,655,581	10.9
STENTON NDËRTIM SHPK Manastir	282,610,000	4,595,285	10.7
EURO - FARM SHPKPV Manastir	200,375,488	3,258,138	7.6
CARSO PHARM SHPKPV Ilinden	191,296,014	3,110,504	7.3
EKSPEKTA MEDIKALL SHPKPV Shkup	162,288,350	2,638,835	6.2
Totali	1,691,364,831	27,501,867	64.3



Klinika e Radioterapisë dhe Onkologjisë në vitin 2024 ka nënshkruar kontrata me vlerë prej 31.8 milionë euro. Gjatë kësaj, gjashtë kompanitë me vlerën më të madhe të kontratave kanë fituar gjithsej 28 milionë euro dhe kanë një pjesëmarrje prej deri 89 %. Këtu, pjesëmarrja është jashtëzakonisht e lartë për dy kompanitë e para, SHA D-R PANOVSKI Shkup dhe ALLKALLOID KONS SHPKPV Shkup.

Prezantim i përqendrimit të kontratave të ndara në Klinikën për Radioterapi dhe Onkologji në vitin 2024

Emri i kompanisë	Vlera e kontratave të nënshkruara në denarë	Vlera e kontratave të nënshkruara në euro	Përqindja e tenderëve të fituar
SHA D-R PANOVSKI Shkup	1,024,863,802	16,664,452	52.3
ALLKALLOID KONS SHPKPV Shkup	424,182,541	6,897,277	21.7
CARSO PHARM SHPKPV Ilinden	101,536,766	1,651,004	5.2
VARUS SHPKPV Shkup	85,859,786	1,396,094	4.4
BI-MEK SHPK Shkup	54,445,705	885,296	2.8
GALINOS FARM SHPK Ilinden	51,052,085	830,115	2.6
Totali	1,741,940,685	28,324,239	89.0

Klinika për Sëmundjet e Fëmijëve në vitin 2024 ka nënshkruar kontrata me vlerë prej thajse 16 milionë euro. Gjatë kësaj, në rastin e kësaj klinike, gjashtë kompanitë me vlerën më të lartë në tenderët kanë kontrata me shumën prej 12.3 milionë euro dhe pjesëmarrje prej 76.8 %. Në këtë klinikë, gjithashtu shumë e lartë është pjesëmarrja e një kompanie, përkatësisht e ALLKALLOID KONS edhe atë deri në 56.8 %.

Prezantim i përqendrimit të kontratave të ndara në Klinikën për Sëmundjet e Fëmijëve në vitin 2024

Emri i kompanisë	Vlera e kontratave të nënshkruara në denarë	Vlera e kontratave të nënshkruara në euro	Përqindja e tenderëve të fituar
ALLKALLOID KONS SHPKPV Shkup	557,061,929	9,057,918	56.8 %
SHA D-R PANOVSKI Shkup	48,371,912	786,535	4.9 %
BIOTECH SHPK Shkup	41,394,905	673,088	4.2 %
EURO - FARM SHPKPV Manastir	41,057,308	667,599	4.2 %
FARMA TREJD SHPKPV Shkup	33,765,505	549,033	3.4 %
FARMAHEM SHPKPV Shkup	32,441,367	527,502	3.3 %
Totali	754,092,926	12,261,674	76.8 %

Institucioni publik në fushën e kujdesit shëndetësor për nevojat e institucioneve publike të kujdesit shëndetësor, klinikave universitare, instituteve dhe qendrave të urgjencës ka një strukturë shumë të larmishme dhe në këtë institucion, shteti është në vendin e parë me ESM SHITJE SHPKPV Shkup për blerje të energjisë elektrike. Përndryshe, edhe në këtë institucion publik shëndetësor, pjesëmarrja e gjashtë të parëve është 58.3 %.

Prezantim i përqendrimit të kontratave të ndara në Institucionin publik nga fusha e kujdesit shëndetësor për nevojat e institucioneve publike shëndetësore... në vitin 2024

Emri i kompanisë	Vlera e kontratave të nënshkruara në denarë	Vlera e kontratave të nënshkruara në euro	Përqindja e tenderëve të fituar
ESM SHITJE SHPKPV Shkup	165,200,000	2,686,179	22.5
ALLKALLOID KONS SHPKPV Shkup	70,886,791	1,152,631	9.7
TGS GAZRA TEKNIKE SHPK Shkup	64,244,230	1,044,622	8.8
MEDICAL ADVANCE SHPKPV Shkup	53,337,581	867,278	7.3
VIZIOMED GBG SHPKPV Shkup	42,925,188	697,971	5.8
EKOURLBAN SHPKPV SHKUP	31,695,952	515,381	4.3
Totali	428,289,742	6,964,061	58.3

Klinika e Hematologjisë në vitin 2024 ka nënshkruar kontrata në vlerë prej 11 milion euro. Gjatë kësaj, gjashtë kompanitë me vlerën më të madhe të kontratave kanë fituar gjithsej 9.2 milionë euro dhe kanë pjesëmarrje prej madje 83.6 %. Këtu, pjesëmarrja është jashtëzakonisht e lartë edhe për një kompani, SHA D-R PANOVSKI Shkup edhe atë 58.9 %.

Prezantim i përqendrimit të kontratave të ndara në Klinikën e Hematologjisë në vitin 2024

Emri i kompanisë	Vlera e kontratave të nënshkruara në denarë	Vlera e nënshkruara të lidhura në euro	Përqindja e tenderëve të fituar
SHA D-R PANOVSKI Shkup	398,830,294	6,485,045	58.9
MEDITREJD 94 SHPKPV Shkup	56,578,768	919,980	8.4
MAKEDONIJALEK SHPK Shkup	38,571,869	627,185	5.7
ALLKALLOID KONS SHPKPV Shkup	29,803,030	484,602	4.4
GALINOS FARM SHPK Ilinden	25,249,126	410,555	3.7
FARMA TRADE SHPKPV Shkup	17,226,697	280,109	2.5
Totali	566,259,784	9,207,476	83.6

Klinika e Kardiologjisë në vitin 2024 ka nënshkruar kontrata për prokurime publike në vlerë 9.6 milionë euro, nga të cilat pothuajse 6.9 milionë, apo 71.4 %, u përkasin gjashtë kompanive.

Prezantim i përqendrimit të kontratave të ndara në Klinikën e Kardiologjisë në vitin 2024

Emri i kompanisë	Vlera e kontratave të nënshkruara në denarë	Vlera e kontratave të nënshkruara në euro	Përqindja e tenderëve të fituar
ALLKALLOID KONS SHPKPV Shkup	129,222,816	2,101,184	21.8
BIO MEDIKA SHPKPV Shkup	80,160,413	1,303,421	13.5
FARMA TREJD SHPKPV Shkup	74,220,775	1,206,842	12.5
MAKMONT SHPKPV Shkup	49,796,000	809,691	8.4
SINERXHI MEDIKALL SHPK Shkup	45,855,717	745,621	7.7
SHA D-R PANOVSKI Shkup	43,585,208	708,703	7.4
Totali	422,840,929	6,875,462	71.4

Klinika e Neurologjisë ka bindshëm nivelin më të lartë të përqendrimit të gjashtë kompanive deri më tani, edhe atë një nivel të lartë prej 91.1 %. Ky përqendrim është rezultat i faktit se nga totali i kontratave për prokurime publike të nënshkruara me vlerë prej rreth 7.2 milionë euro, madje 6.5 milionë euro janë me gjashtë kompani. Në këtë klinikë, ka edhe një përqendrim të lartë të tre kompanive të para me aksione individuale nga 32.9 % deri në 16.4 %.

Prezantim i përqendrimit të kontratave të ndara në Klinikën e Neurologjisë në vitin 2024

Emri i kompanisë	Vlera e kontratave të nënshkruara në denarë	Vlera e kontratave të nënshkruara në euro	Përqindja e tenderëve të fituar
FARMA TRAEJD SHPKPV Shkup	144,991,476	2,357,585	32.9
VARUS SHPKPV Shkup	124,657,344	2,026,949	28.3
EURO - FARM SHPKPV Manastir	72,175,052	1,173,578	16.4
ZEGIN SHPK Shkup	35,754,554	581,375	8.1
ALLKALLOID KONS SHPKPV Shkup	13,106,888	213,120	3.0
PROMEDIKA SHPK Shkup	10,199,166	165,840	2.3
Totali	400,884,480	6,518,447	91.1

Instituti i Mjekësisë së Transfuzionit në vitin 2024 ka nënshkruar kontrata me vlerë prej 6.7 milionë euro. Gjatë kësaj, gjashtë kompanitë me vlerën më të lartë të tenderëve rezultojnë se kanë kontrata me shumën rreth 5.5 milionë euro dhe pjesëmarrje prej 81.7 %. Edhe te ky institucion publik shëndetësor, pjesëmarrjet individuale të kompanive janë gjithashtu jashtëzakonisht të larta, me çka dy kompanitë e para së bashku kanë një pjesëmarrje prej pothuajse gjysmë të tenderëve.

Prezantim i përqendrimit të kontratave të ndara në Institutin e Mjekësisë së Transfuzionit në vitin 2024

Emri i kompanisë	Vlera e kontratave të nënshkruara në denarë	Vlera e kontratave të nënshkruara në euro	Përqindja e tenderëve të fituar
AVICENA SHPK Shkup	117,654,434	1,913,080	28.5
BIOTEK SHPK Shkup	87,634,910	1,424,958	21.2
DIAHEM SHPK Shkup	50,017,649	813,295	12.1
FARMAHEM SHPK Shkup	38,180,841	620,827	9.2
SHA D-R PANOVSKI Shkup	30,929,107	502,912	7.5
BIOMEDIKA DIAGNOSTIKA SHPKP Shkup	13,150,515	213,830	3.2
Totali	337,567,456	5,488,902	81.7

Shtëpia e Shëndetit Shkup është gjithashtu një ndër dhjetë institucionet më të mëdha të shëndetit publik me nivel të lartë përqendrimi midis një numri të kufizuar kompanish. Në vitin 2024, ky institut ka nënshkruar total kontrata për prokurime publike në vlerë prej 6.3 milionë euro. Përveç kësaj, 61.7 % e vlerës së tenderëve, apo rreth 3.9 milionë euro, janë nënshkruar me gjashtë kompani.

Prezantim i përqendrimit të kontratave të ndara në Shtëpinë e Shëndetit Shkup në vitin 2024

Emri i kompanisë	Vlera e kontratave të nënshkruara në denarë	Vlera e kontratave të nënshkruara në euro	Përqindja e tenderëve të fituar
EKSPEKTA MEDIKAL SHPKPV Shkup	99,851,600	1,623,603	25.8
AVICENA SHPK Shkup	77,467,000	1,259,626	20.0
SPIDER GRUP SHPKPV Shkup	21,240,000	345,366	5.5
MAKS FLAM SHPKPV Shkup	14,160,000	230,244	3.7
TEHNOKOMERC SHA Shkup	14,124,600	229,668	3.6
BIOTEK SHPK Shkup	12,213,000	198,585	3.2
Totali	239,056,200	3,887,093	61.7

Ky nivel përqendrimi tregon se institucionet publike të kujdesit shëndetësor varen shumë nga një numër i kufizuar furnizuesish, gjë që zvogëlon fuqinë negociuese të institucioneve dhe rrit mundësinë për një sjellje të koordinuar midis firmave ose për oferta më pak konkurrense.

